

PYETËSORI NDËRKOMBËTAR I TRAUMËS (ITQ) - VERSIONI SHQIP
THE INTERNATIONAL TRAUMA QUESTIONNAIRE (ITQ) - ALBANIAN VERSION
Përkthyer në gjuhën shqipe nga Alfred Nela

PËRMBLEDHJE:

Instrumenti i bashkëngjitur është një shkallë matëse e shkurtër dhe e formuluar thjesht, që përqendrohet vetëm në tiparet kryesore të Çrregullimit të Stresit Post-Traumatik (ÇSPT) dhe Çrregullimit Kompleks të Stresit Post-Traumatik (ÇKSPT) dhe përdor rregulla të thjeshta diagnostikuese. ITQ është zhvilluar për të qenë në përputhje me parimet e klasifikimit statistikor ndërkombëtar të sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin, revizioni i 11-të, siç përcaktohen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, të cilat synojnë maksimizimin e dobisë klinike dhe sigurimin e zbatueshmërisë ndërkombëtare duke u fokusuar në simptomat kryesore të një çrregullimi të caktuar. ITQ është lirisht i disponueshëm në domenin publik për të gjitha palët e interesuara. Vlerësimi i matësit vazhdon, veçanërisht pasi lidhet me përkufizimin e dëmtimit funksional si për ÇSPT ashtu edhe për ÇKSPT dhe ndoshta përmbajtjen e aspekteve pasi ato mund të lidhen me parashikimin e rezultatit të trajtimit diferencial.

ALGORITMET DIAGNOSTIKE janë si më poshtë:

ÇSPT.

Një diagnozë e ÇSPT kërkon miratimin e njërit prej dy simptomave nga grupet e simptomave të (1) ripërjetime të momentit, (2) shmangies dhe (3) ndjenjës së kërcënimit aktual, plus miratimin e të paktën një treguesi të dëmtimit funksional të shoqëruar me këto simptoma. Miratimi i një simptome ose artikulli të dëmtimit funksional përcaktohet si një pikëzim > 2.

ÇKSPT.

Një diagnozë e ÇKSPT kërkon miratimin e njërit prej dy simptomave nga secili prej tre grupeve të simptomave të ÇSPT (ripërjetimi në këtu dhe tani, shmangia dhe ndjenja e kërcënimit aktual) dhe njërit prej dy simptomave nga secili prej tre grupeve të Çrregullimeve në Vetë-Organizim (ÇVO): (1) çrregullim afektiv, (2) vetëkoncept negativ dhe (3) çrregullime në marrëdhënie. Dëmtimi funksional duhet të identifikohet kur të paktën një tregues i dëmtimit funksional miratohet në lidhje me simptomat e ÇSPT dhe një tregues i dëmtimit funksional miratohet në lidhje me simptomat e ÇVO. Miratimi i një simptome ose aspekti të dëmtimit funksional përcaktohet si një pikëzim > 2.

Një individ mund të diagnostikohet me ÇSPT ose ÇKSPT, por jo me të dyja. Nëse një person plotëson kriteret për CPTSD, ai person mund të diagnostikohet gjithashtu me PTSD.

Udhëzimet për pikëzimin janë të disponueshme në fund të këtij dokumenti.

REFERENCAT e shkallës matëse janë:

Cloitre, M., Shevlin M., Brewin, C.R., Bisson, J.I., Roberts, N.P., Maercker, A., Karatzias, T., Hyland, P. (in press). The International Trauma Questionnaire: Development of a self-report measure of ICD-11 PTSD and Complex PTSD. *Acta Psychiatrica Scandinavica*. DOI: 10.1111/acps.12956

SFONDI I PUBLIKIMEVE

Redican, E., Nolan, E., Hyland, P., Cloitre, M., McBride, O., Karatzias, T., Murphy, J., & Shevlin, M. (2021). A systematic literature review of factor analytic and mixture models of ICD-11 PTSD and CPTSD using the International Trauma Questionnaire. *Journal of Anxiety Disorders*, 79, 102381.

<https://doi.org/10.1016/j.janxdis.2021.102381>

Brewin, C. R., Cloitre, M., Hyland, P., Shevlin, M., Maercker, A., Bryant, R. A.,...Reed, G. M. (2017). A review of current evidence regarding the ICD-11 proposals for diagnosing PTSD and complex PTSD. *Clinical Psychology Review*, 58, 1-15. doi: 10.1016/j.cpr.2017.09.001.

Hyland, P., Brewin, C. R., Cloitre, M., Karatzias, T., & Shevlin, M. (2024). Responding to concerns related to the measurement of ICD-11 complex posttraumatic stress disorder using the International Trauma Questionnaire. *Child Abuse & Neglect*, 147, 106563.
<https://doi.org/10.1016/j.chiabu.2023.106563>

Cloitre, M., Hyland, P., Prins, A., & Shevlin, M. (2021). The international trauma questionnaire (ITQ) measures reliable and clinically significant treatment-related change in PTSD and complex PTSD. *European Journal of Psychotraumatology*, 12(1), 1930961.
<https://doi.org/10.1080/20008198.2021.1930961>

PYETËSORI NDËRKOMBËTAR I TRAUMËS

Udhëzime: Ju lutemi identifikoni përvojën që ju shqetëson më shumë dhe përgjigjuni pyetjeve në lidhje me këtë ngjarje.

Përshkrim i shkurtër i ngjarjes _____

Kur ndodhi ngjarje? (rrethoni një)

- a. më pak se 6 muaj më parë
- b. 6 deri në 12 muaj më parë
- c. 1 deri në 5 vjet më parë
- d. 5 deri në 10 vjet më parë
- e. 10 deri në 20 vjet më parë
- f. më shumë se 20 vjet më parë

Më poshtë janë disa probleme që njerëzit ndonjëherë i raportojnë si përgjigje ndaj ngjarjeve traumatike ose stresuese të jetës. Ju lutemi lexoni me kujdes secilën pikë, pastaj rrethoni një nga numrat në të djathtë për të treguar se sa shumë ju ka shqetësuar ai problem gjatë muajit të kaluar.

	<i>Aspak</i>	<i>Pak</i>	<i>Mesatarisht</i>	<i>Mjaft</i>	<i>Jashtëzakonisht</i>
P1. A keni ëndrra shqetësuese që rikujtojnë një pjesë të ngjarjes ose lidhen qartë me ngjarjen?	0	1	2	3	4
P2. A keni imazhe ose kujtime të fuqishme që ndonjëherë ju vijnë në mendje, në të cilat mendoni se ngjarja po ndodh përsëri këtu dhe tani?	0	1	2	3	4
P3. A i shmangni kujtimet e brendshme të ngjarjes (për shembull, mendime, ndjenja ose ndjesi fizike)?	0	1	2	3	4
P4. A i shmangni kujtimet e jashtme të ngjarjes (për shembull, njerëz, vende, biseda, objekte, aktivitete ose situata)?	0	1	2	3	4
P5. A ishit tepër vigjilentë, të vëmendshëm ose në gjendje gatishmërie?	0	1	2	3	4
P6. Ndihehi të shqetësuar ose trembeni lehtë?	0	1	2	3	4
<i>A kanë vazhduar problemet e lartpërmendura gjatë muajit të fundit?</i>					
P7. A kanë ndikuar në marrëdhëniet tuaja me njerëzit e tjerë dhe në jetën shoqërore në përgjithësi?	0	1	2	3	4
P8. A ka ndikuar në punën ose aftësinë tuaj për të punuar? A kanë ndikuar ato në punën ose aftësinë tuaj për të punuar?	0	1	2	3	4
P9. A ka ndikuar në ndonjë pjesë tjetër të rëndësishme të jetës suaj, siç është prindërimi, puna, shkollimi ose studimi, apo aktivitete të tjera të rëndësishme?	0	1	2	3	4

Më poshtë janë problemet që njerëzit kanë përjetuar ndonjëherë nga ngjarjet e kaluara stresuese ose traumatike. Pyetjet i referohen mënyrave se si ndiheni zakonisht, mënyrave se si mendoni zakonisht për veten dhe mënyrave se si lidheni zakonisht me të tjerët. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke menduar se sa e vërtetë është secila deklaratë për ju.

<i>Sa e vërtetë është kjo nga ana juaj?</i>	<i>Aspak</i>	<i>Pak</i>	<i>Mesatarisht</i>	<i>Mjaft</i>	<i>Jashtëzakonisht</i>
C1. Kur jam i mërzhitur, më duhet shumë kohë për t'u qetësuar.	0	1	2	3	4
C2. Ndihehem i mpirë ose i mbyllur emocionalisht.	0	1	2	3	4
C3. Ndihehem si një dështak.	0	1	2	3	4
C4. Ndihehem i pavlerë.	0	1	2	3	4
C5. Ndihehem i vetmuar ose i shkëputur nga njerëzit.	0	1	2	3	4
C6. E kam të vështirë të qëndroj emocionalisht i afërt me njerëzit.	0	1	2	3	4

A keni përjetuar problemet e lartpërmendura në fushat e ndjenjave, qëndrimeve ndaj vetes dhe marrëdhënieve gjatë muajit të fundit?

C7. A ka krijuar shqetësime ose ankth në lidhje me marrëdhëniet ose jetën tuaj shoqërore?	0	1	2	3	4
C8. A ka ndikuar në punën ose aftësinë tuaj për të punuar?	0	1	2	3	4
C9. A ka ndikuar në ndonjë pjesë tjetër të rëndësishme të jetës suaj, siç janë prindërimi, puna , shkollimi ose studimi, apo aktivitete të tjera të rëndësishme?	0	1	2	3	4

1. Pikëzimi diagnostik për ÇSPT dhe ÇKSPT

ÇSPT

Nëse plotësohen kriteret P1 ose P2 > 2 për Ri-përjetime të momentit, (Re-experiencing in the here and now -Re_dx).

Nëse plotësohen kriteret P3 ose P4 > 2 për Shmangien, (Avoidance -Av_dx).

Nëse plotësohen kriteret P5 ose P6 > 2 për Ndjenjën e kërcënimit aktual, (Sense of current threat-Th_dx).

Dhe

Të paktën një nga P7, P8 ose P9 > 2 plotëson kriteret për dëmtimin funksional të ÇSPT, (functional impairment-PTSDFI).

Nëse plotësohen kriteret për 'Re_dx' dhe 'Av_dx' dhe 'Th_dx' dhe 'PTSDFI', kriteret për ÇSPT plotësohen.

ÇKSPT

Nëse plotësohen kriteret C1 ose C2 > 2 për çrregullim afektiv, (Affective dysregulation- AD_dx).

Nëse plotësohen kriteret C3 ose C4 > 2 për vetëkoncept negativ, (Negative self-concept -NSC_dx).

Nëse plotësohen kriteret C5 ose C6 > 2 për çrregullime në marrëdhënie, (Disturbances in relationships -DR_dx).

Dhe

Të paktën një nga C7, C8 ose C9 > 2 plotëson kriteret për dëmtim funksional të DSO-së (DSOFI)

Nëse plotësohen kriteret për 'AD_dx' DHE 'NSC_dx' dhe 'DR_dx', dhe 'DSOFI', plotësohen kriteret për DSO.

ÇSPT diagnostikohet nëse plotësohen kriteret për ÇSPT, por JO për DSO.

ÇKSPT diagnostikohet nëse plotësohen kriteret për ÇSPT dhe plotësohen kriteret për DSO.

Mosplotësimi i kritereve për ÇSPT ose përmbushja vetëm e kritereve për DSO rezulton në mungesë të diagnozës.

2. Pikëzimi dimansional për ÇSPT dhe ÇKSPT

Rezultatet mund të llogariten për secilin grup simptomash të ÇSPT dhe DSO dhe të mblidhen për të prodhuar rezultatet e PTSD dhe DSO.

ÇSPT

Shuma e rezultateve Likert për P1 dhe P2 = Ripërjetimi i momentit, (Re -experiencing in the here and now -Re).

Shuma e rezultateve Likert për P3 dhe P4 = Rezultati i Shmangies, (Avoidance -Av).

Shuma e rezultateve Likert për P5 dhe P6 = Ndjenja e kërcënimit aktual, (Sense of current threat -Th).

Rezultati i PTSD = Shuma e Re, Av dhe Th.

DSO

Shuma e rezultateve Likert për C1 dhe C2 = Çrregullim afektiv, (Affective dysregulation -AD).

Shuma e rezultateve Likert për C3 dhe C4 = Vetëkoncept negativ, (Negative self-concept -NSC).

Shuma e rezultateve Likert për C5 dhe C6 = Çrregullime në marrëdhënie, (Disturbances in relationships -DR)

Rezultati i DSO = Shuma e AD, NSC dhe DR